



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



RAPORTI VJETOR

për punën e

Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2016

Mars 2017



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Raporti vjetori për punën e Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës në vitin 2016 është hartuar në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr 145/10, 136/11, 41/2014 dhe 53/16), ku është përcaktuar detyrimi për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës që më së voni me 31 mars të vitit të ardhshëm, të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të parashtron Raportin vjetor për punën e Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin e kaluar.

Në raportin vjetor janë të përfshirë informacione të detajuara për kompetencat që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e konkurrencës dhe Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, si dhe informacione detale për punën materialo-financiar të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në këtë raport është dhënë një pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë vitit 2016. Me këtë rast i është dhënë një fokus i veçantë aktiviteteve të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës (lëndët sipas të cilit ka vepruar Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës në procedurën administrative dhe lëndët sipas të cilit ka vepruar Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës në procedurën administrative, analizat përgatitura në treg dhe mendimet e dhëna) dhe aktivitetet lidhur me zbatimin e Ligjit për Kontroll të Ndhmës Shtetërore (para së gjithash vendimet e miratuara në procedurën e vlerësimit të kompatibilitetit të ndihmës shtetërore), si dhe hartimin e rregullave tjerë që janë në kompetencë të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Në këtë raport janë paraqitur aktivitetet në të cilën Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i ka realizuar gjatë vitit 2016 në planin ndërkombëtar. Në fund të raportit është dhënë një pasqyrë e punës financiare të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2016.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
A. KONKURRENCA	Error! Bookmark not defined.
1. Korniza ligjore	Error! Bookmark not defined.
1.1 Ligji për mbrojtjen e konkurrencës	Error! Bookmark not defined.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



1.2 Aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.....	Error! Bookmark not defined.
1.3 Udhëzimet, synimet dhe broshurat për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës	Error! Bookmark not defined.
2. Aktivitetet e Komisionit në fushën e mbrojtjes së konkurrencës	8
2.1 Procedurat administrative dhe kundërvajtëse që kryhen (zhvillohen) nga Komisioni.....	Error! Bookmark not defined.
2.2 Marrëveshjet, vendimet dhe sjellja e harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve.....	9
2.3 Keqpërdorimi i pozitës dominuese	12
2.4 Vlerësimi i përqendrimeve të ndërmarrjeve	14
2.5 Bashkëpunimi i Komisionit me trupat rregullator dhe organet tjera shtetërore.....	21
2.6 Mendimet e dhëna nga Komisioni.....	21
3. Transparenca	22
B. NDIHMA SHTETËRORE	22
4. Korniza juridike.....	22
4.1 Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.....	22
4.2 Aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.....	23
5. Parimi metodologjik.....	24
5.1 Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.....	24
6. Aktivitetet e Komisionit	25
6.1 Vendimet/aktvendimet e miratuara për ndihmën e ndarë shtetërore	25
6.2 Ndihma shtetërore sipas instrumenteve.....	28
6.3 Mendimet e Komisionit	28
7. Komentet dhe konkluzionet	29
V. INTEGRIMI NË UE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	30
8. Integrimi në UE.....	30
8.1 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në fushën e antitrust dhe ndihmës shtetërore.....	30
8.2 Bashkëpunimi ndër-dikasterial në planin e integritit evropian.....	31
9. Bashkëpunimi ndërkombëtar	32
9.1 Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral.....	32
9.2 Bashkëpunimi bilateral.....	33
9.3 Bashkëpunimi multilateral.....	33
G. KAPACITETI ADMINISTRATIV I KOMISIONIT	34
D. KONKLUZË.....	34
GJ. RAPORTI FINACIAR.....	36



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



PARATHËNIE

Me Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 04/05, 70/06 dhe 22/07), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komisioni) është i themeluar në vitin 2005 si një organ autonom, kolegial dhe si një organ i pavarur shtetëror, i cili është përgjegjës për punën e tij vetëm para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 145/11, 41/14 dhe 53/16)



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



qëllimi i të cilit është zbulimi, parandalimi dhe sanksionimi i formave të ndryshme të rrezikut, parandalimit dhe prishjes së konkurrencës në treg dhe Ligji për Kontroll të Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10) qëllimi i të cilit është mbikqyrja e çdo forme të ndihmës shtetërore që është ndarë në Republikën e Maqedonisë, në funksion të sigurimit të konkurrencës së lirë dhe tregut konkurrues, i liruara nga ndikimi i ndërhyrjes së shtetit.

Në bazë kompetencave, Komisioni merret me procedurat administrative dhe me procedurat e kundërvajtjes dhe për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës shqipton gjobë si një sanksion për kundërvajtje, sipas dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje.

Gjatë vitit 2016, Komisioni ka miratuar gjithsej 44 vendime në procedurë administrative nga të cilat 31 vendime kanë të bëjnë me kontrollin e përqendrimeve, 13 vendime kanë të bëjë me kontrollin e ndihmës shtetërore. Nga gjithsej 31 vendime për përqendrimet, në 30 vendime është konstatuar se përqendrimet janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërsa në një vendim konstatohet se njoftimi i përqendrimit është i paplotë dhe në pajtim me nenin 39 paragrafi (3) të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), është refuzuar. Sa i përket vendimeve për kontrollin e ndihmës shtetërore, te 10 vendimet konstatohet se masat e përfshira në njoftimet që i dorëzohen Komisionit nga dhënësi i ndihmës shtetërore paraqesin ndihmë shtetërore në bazë të Ligjit për Kontroll të Ndhmës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), ndërsa te 1 vendim, Komisioni konstaton se masat e përfshira në njoftim paraqesin ndihmë me rëndësi të vogël (ndihmë de minimis) respektivisht ndihma e dhënë e cila nuk kalon për përdorues 200.000 euro për një periudhë prej tre vitesh, ndërsa në 2 vendime Komisioni shpalli pavlefshmërinë e ndihmës shtetërore paraprakisht të planifikuar. Në mënyrë plotësuese, Komisioni ka dhënë 4 mendime sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe 20 mendime sipas Ligjit për kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Gjatë vitit 2016, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit, ka miratuar 7 vendime në procedurë kundërvajtës dhe **shqiptoi një gjobë të përgjithshme prej 18.234.926,00** denarë. Pastaj, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në 3 vendime konstatoi ekzistimin e një marrëveshje të ndaluar dhe u shqiptoi një gjobë të përgjithshme në shumën prej 9.754.000,00 denarë, në 2 vendime konstatoi ekzistimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese dhe u shqiptoi një gjobë në shumën prej 8.364.326,00 denarë, ndërsa në 2 vendime konstatoi ekzistimin e kundërvajtjeve më të lehta dhe ka shqiptuar një gjobë në shumën prej 116.600,00 denarë.

Komisioni, duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion është i kënaqur me vëllimin e aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura në fushën e mbrojtjes së konkurrencës dhe kontrollit të ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2016. Përgatitja e këtij raporti vjetor, përveç që paraqet një detyrim ligjor sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, paraqet edhe një mënyrë të dobishme për të siguruar një transparencë në punën e Komisionit, si dhe për njohjen e punës së Komisionit para ekspertëve dhe biznesit publik në Republikën e Maqedonisë. Në fakt, ky Raport ka për qëllim vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Komisioni në vitin 2016 të sistematizohen në një vend edhe pse ato publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e internetit të Komisionit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Blagoj Çurlinov- Kryetar

Çedomir Krlevski- Anëtar¹

Naser Zharku- Anëtar

Snezhana Kostadinovska-Milosheska- Anëtar

Ana Vitkova- Anëtar

A. KONKURRENCA

1. Korniza ligjore

Kornizën ligjore në mbrojtjen e konkurrencës e përbën Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe aktet nënligjore të cilat janë miratuara në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

1.1 Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), i cili është plotësisht i harmonizuar me të drejtën evropiane për mbrojtjen e konkurrencës gjegjësisht nenet 101, 102, 106 dhe 107 të Marrëveshjes për funksionimin e UE-së dhe akteve të UE-së: 32003R0001, 32004R0773, 32004R0139, 31997Y1209(01), 52001XC1222(03), 52006XC1208(04) и 52006XC0901(01). Më 10 tetor 2011 hyri në fuqi **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 136/11) me të cilin bëhet harmonizimi i mëtuqjeshëm i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/2010) i Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/05, 110/08 dhe 51/11), gjegjësisht është bërë një saktësim dhe rregullim i dispozitave për vënien e procedurës për zbatimin e parimit, „heshtje domethënë miratim”. Më 04.03.2014 hyri në fuqi **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 41/14), me të cilin kryhet preciziteti i procedurës për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe kushteve që kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës duhet ti plotësojnë.

¹ Kryetar i Komisionit për Vendimarrje për Kundërvajtje (neni 30 i ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës)



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



1.2 Aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: LMK)

Me propozim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 23.03.2012 miratoi 9 (nëntë) rregullore që burojnë nga LMK:

1. Rregullorja për kushtet më të afërta për marrëveshjet më rëndësi të vogël („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar masa e UE-së 52001XC1222(03);
2. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e njoftimit të përqendrimit dhe dokumentacioni i kërkuar që parashtrohet së bashku me njoftimin („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32004R0802;
3. Rregullorja për përjashtime grupore të llojeve të caktuara të marrëveshjeve për sigurim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0267;
4. Rregullorja për kushtet më të afërta për përjashtime grupore të llojeve të caktuara të marrëveshjeve horizontale të specializimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R1218;
5. Rregullorja për kushtet më të afërta për përjashtime grupore të llojeve të caktuara të marrëveshjeve për transferimin e teknologjisë, licencës, ose know-how („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32004R0772;
6. Rregullorja për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara të marrëveshjeve vertikale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0330;
7. Rregullorja për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara për distribucion dhe servisim të automjeteve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0461;
8. Rregullorja për kushte më të afërta për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara për hulumtim dhe zhvillim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R1217 dhe
9. Rregullorja për kushte më të afërta për lirimin ose zvogëlimin e gjobës dhe procedura sipas të cilit Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje vendos për lirimin ose zvogëlimin e gjobës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar masa e UE-së 52006XC1208(04).

Me këto rregullore është arrit një shkallë më e lartë e harmonizimit legjislativ nacional me UE *acquis*.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



1.3. Udhëzimet, synimet dhe broshurat për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës

Në vitin 2016, Komisioni ka përgatitur dhe miratuar udhëzimet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për verifikimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Këto udhëzime janë në përputhje me Udhëzimet e Komisionit mbi procedurën e thjeshtuar për vlerësimin e përqendrimeve të caktuara në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) 139/2004 (2013 / C 366/04)
2. Udhëzimet për heqjen ose zvogëlimin e gjobës

2. Aktivitetet e Komisionit në vitin 2016 në fushën e mbrojtjes së konkurrencës

Aktivitetet themelore që Komisioni i kryen në bazë të LMK-së janë:

- udhëheqja e procedurave për përcaktimin e ekzistimit të kundërvajtjeve që janë të përcaktuara në LMK;
- udhëheqja e procedurave administrative për vlerësimin e përqendrimeve;
- analiza e gjendjes në tregjet e caktuara;
- dhënie e mendimeve.

2.1 Procedurat administrative dhe kundërvajtës që kryhen (zhvillohen) nga Komisioni në vitin 2016

LMK vërteton tri forma themelore të veprimtarisë së ndërmarrjes që mund të parandaloj , kufizoj ose prish konkurrencën në treg. Këto janë: marrëveshjet e ndaluara, keqpërdorimi i pozitës dominuese dhe përqendrimet e ndaluara. Prandaj, fushëveprimi i Komisionit, në kuptimin më të ngushtë të fjalës, i përfshinë fushat e mëposhtme:

- vërtetimi i ekzistimit të marrëveshjeve të ndaluara, vendimeve dhe sjelljeve të harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve;
- keqpërdorimi me pozitën dominuese nga ndërmarrjet që zotërojnë një pozitë dominuese dhe
- kontrolli i përqendrimeve të ndërmarrjeve.

Vërtetimi i ekzistimit të marrëveshjeve të ndaluara, vendimeve dhe sjelljeve të harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve dhe ekzistimi i keqpërdorimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet që zotërojnë një pozitë dominuese kryhen në procedurat për kundërvajtje. Procedurat për kundërvajtje që kryhen dhe miratojnë vendime është Komisioni për Vendimarrje për Kundërvajtje në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KVK) i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë të



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës që profesionalisht janë të angazhuar në punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kontrolli i përqendrimeve të ndërmarrjeve kryhet në procedurat administrative që i udhëheq dhe për të cilat miraton një vendim Komisioni.

2.2 Marrëveshjet, vendimet dhe sjelljet e harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve

Në bazë të LMK, janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve, si dhe çdo sjellje e harmonizuar që prodhon efekt në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe qëllimi i të cilit është parandalimi, kufizimi ose prishja e konkurrencës. Kjo ndalesë siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi 1 i LMK-së, veçanërisht vlen për ato marrëveshje, vendime apo praktikave kontraktuese qëllimi ose pasoja e të cilit është:

- drejtperdrejt ose terthorazi i fiksojnë cmimet e blerjes ose të shitjes ose disa kushte tjera për tregtim;
- e kufizojnë ose e kontrollojnë prodhimtarinë, tregun, zhvillimin teknik ose investimet;
- e ndajne tregun ose burimet e furnizimit;
- zbatojnë kushte të ndryshme për pune juridike të njëjta ose të ngjashme me partneret tjere tregtare, me çfare i vene në pozite të pavolitshme konkurruese dhe
- e kushtezojnë lidhjen e marrëveshjeve me pranim nga palet tjera kontraktuese obligime shtese, që sipas nat-yres së vet ose në pajtim me traditat tregtare nuk lidhen me lenden e marrëveshjes.

Nga ana tjetër, marrëveshjet vendimet, respektivisht praktikat kontraktuese që kanë për qëllim ose pasojë parandalimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës, sipas nenit 7 paragrafi (3) të LMK, mund të përjashtohen nga zbatimi i nenit 7 paragrafi (1) i LMK-së, në qoftë se ato kontribuojnë në avancimin e prodhimtarisë ose distribuimin e mallrave ose shërbimeve ose promovimin e zhvillimit teknik ose ekonomik, me kusht që nga ajo të kenë dobi proporcionale edhe konsumatorët, e të cilat nuk u imponojnë ndërmarrjeve përkatëse kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e atyre qëllimeve dhe nuk u mundësojnë atyre ndërmarrjeve eliminim të konkurrencës në vëllim të konsiderueshëm për mallrat ose shërbimet për të cilët bëhet fjalë..

Përveç këtyre përjashtimeve grupore, sistemi maqedonas i mbrojtjes së konkurrencës njih edhe të ashtuquajtura përjashtime grupore për kategori të veçanta të kontratave edhe atë:

- marrëveshjet vertikale;
- marrëveshjet horizontale për hulumtim dhe zhvillim;
- marrëveshjet për transferim të teknologjisë, për licencë ose për know-how;
- marrëveshjet për distribuim ose servisim të automjeteve dhe
- marrëveshjet për sigurim.

Përjashtimet grupore të këtyre kategorive të marrëveshjeve bëhet në bazë të rregulloreve përkatëse të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2012 (shiko pikën 1.2).

Në vitin 2016 KVK miratoi 3 vendime në procedurën e kundërvajtjes në të cilat konstatoi ekzistimin e marrëveshjes së ndaluar edhe atë:

1. **Vendimi PK nr. 09-22/17 më 31,08.2016** me të cilin KVK konstaton që Shoqata e Mjekëve Privatë të Republikës së Maqedonisë, si shoqatë e ndërmarrjeve, në



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



periudhën prej 10.03.2012 deri në ditën e miratimit të aktvendimit sollën një vendim të ndaluar, në atë mënyrë që Këshilli Drejtues i Shoqatës së Mjekëve Privatë të Republikës së Maqedonisë miratuan një vendim nr. ngjashëm me 10.03.2012, ku u miratua lista e çmimeve për pacientët private dhe shërbimeve private, një vendim që rregullon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çmimet e shitjes së shërbimeve për pacientët privatë dhe shërbimet private, qëllimi i të cilit është parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës, me të cilën ka kryer kundërvajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1), dhe në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së, ku kryerësit të Shoqatës së Mjekëve Privat të Republikës së Maqedonisë i shqiptohet një sanksion - gjobë në shumë prej 491,000 denarë. Pas vendimit të lartpërmendur, është ngrit një padi në Gjykatën Administrative.

2. **Vendimi PK nr. 09-2/18 më 23.12.2016**, me të cilin KVK konstaton që Digi Plus Multimedia SHPKNJP Shkup dhe FOX Networks Group Bulgaria EOOD (ish FOX International Channels Bulgaria EOOD), kanë lidhur një marrëveshje të ndaluar më 28.10.2009, qëllimi ose pasoja e të cilit është parandalimi, kufizimi ose prishja e konkurrencës dhe të njëjtin e kanë ybatuar deri më 01.12.2010. në atë mënyrë që në Marrëveshjen për kushtet e shpërndarjes së kanaleve, inkorporuar dy dispozita me të cilat palët kontraktuese aplikuan kushte të ndryshme për çështje të njëjta ose të ngjashme ligjore me partnerët e tjerë tregtarë, me ç'rast partnerët e tjerë tregtarë i vendosën ata në një pozitë konkurruese të pafavorshme në tregun e kanaleve me një program të përkthimit maqedonas që transmetohet në territorin e Republikës së Maqedonisë, me të cilat kanë kryer një kundërvajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së. Për kundërvajtjen e kryer KVK i shqiptoi një gjobë Digi Plus Multimedia SHPKNJP Shkup në shumën prej 1.493.000,00 denarë, ndërsa kryerësit të FOX Networks Group Bulgaria EOOD (ish FOX International Channels Bulgaria EOOD), i shqiptoi një gjobë në shumë prej 1.257.000,00 denarë. Vendimi i lartpërmendur është përfundimtare dhe ekzekutive dhe ndaj të njejtës është vepruar.
3. **Vendimi PK nr. 09-18/20 më 29.12.2016**, me të cilin KVK konstaton që Digi Plus Multimedia SHPKNJP Shkup dhe DISCOVERY COMMUNICATIONS EUROPE LIMITED, Londër, Mbretëria e Bashkuar më datë 09.11.2009, kanë lidhur një marrëveshje të ndaluar për shpërndarjen e kanaleve - një listë të afateve që transmetohen në territorin e Republikës së Maqedonisë, në mënyrë që në marrëveshje të përfshijnë një dispozitë me të cilën palët kontraktuese aplikojnë kushte të ndryshme për të njëjtat ose çështje të ngjashme ligjore me partnerët e tjerë tregtarë, duke i vënë partnerët e tjerë tregtarë në një pozitë konkurruese të pafavorshme në tregun e kanaleve dokumentare / edukative me përkthim në gjuhën maqedonase, të cilat transmetohen në territorin e Republikës së Maqedonisë me të cilat kanë kryer një kundërvajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së. Për kundërvajtjen e kryer KVK i shqiptoi një gjobë Digi Plus Multimedia SHPKNJP Shkup në shumën prej 2,737,000.00 euro, ndërsa për DISCOVERY COMMUNICATIONS EUROPE LIMITED, Londër, Mbretëria e Bashkuar i shqiptoi një gjobë prej 3,776,000.00 denarë. Vendimi i lartpërmendur është përfundimtare dhe ekzekutive dhe ndaj të njejtës është vepruar.

2.3 Keqpërdorimi i pozitës dominuese



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Në bazë LMK -së ndalohet çdo keqpërdorim i pozitës dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant ose pjesës së tij thelbësore. Në LMK janë dhënë 6 raste të cilët paraqesin keqpërdorim të pozitës dominuese:

- imponim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të cmimeve të padrejta të blerjes ose të shitjes ose kushteve tjera të padrejta të tregimit;
- kufizim të prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;
- aplikim të kushteve të ndryshme për punë juridike të njëjta ose të ngjashme me partnerë tjerë tregtarë, me çfarë vihen në pozitë të pavolitshme konkurruese;
- kushtëzim të lidhjes së marrëveshjeve me pranim nga palët tjera kontraktuese obligime shtesë, që sipas natyrës së vet ose në pajtim me traditat tregtare, nuk lidhen me lëndën e marrëveshjes;
- refuzimi të tregtohet ose nxitja dhe kërkesa nga ndërmarrjet tjera ose shoqatat e ndërmarrjeve të mos blejnë ose shesin mallra, ose shërbime në ndonjë ndërmarrje të caktuar, me qëllim që në mënyrë të pandershme t'i shkaktohet dëm asaj ndërmarrjeje dhe
- refuzimit të paarsyeshëm që t'i mundësohet qasje në rrjetin personal ose objekte tjera infrastrukturore ndërmarrjes tjetër për kompensim përkatës, nëse pa shfrytëzimin e kësaj të njëkohshëm, ndërmarrja tjetër, për shkaqe juridike ose faktike t'i pamundësohet të veprojë si një konkurrent i ndërmarrjes dominuese.

Në vitin 2016, KVK miratoi 2 vendime në procedurën për kundërvajtje në të cilën konstatoi ekzistimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese edhe atë:

1. **Vendimi PK nr. 09-17/18 më 13.10.2016,** me të cilin KVK në procedurën e kundërvajtjes konstatoi që

- Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të autorit të muzikës ZAMP, si organizata e vetme në treg për menaxhimin kolektiv të së drejtës për ritransmetimin kabllor të veprave muzikore jo-aktive, në territorin e Republikës së Maqedonisë ka një pozitë dominuese. E njëjta e ka keqpërdorur në periudhën prej vitit 2011-2015 nëpërmjet dhënies të një zbritje të caktuar të kompensimit të licencës për ritransmetimin e programeve dhe veprave të përfaqësuara nga ZAMP, e lidh atë me nënshkrimin paraprak të një Marrëveshjeje të Përgjithshme të Licencës lidhur me lejen për një ritransmetim të njëkohshëm, të pandryshuar dhe të pakufizuar të programeve televizive që janë në Koordinimin Kabllor të EBU- VG Media Gesellschaft dhe televizioni RTL me anë të ADSL / IPTV dhe rrjetit kabllor në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2011-2015. Për kundërvajtjen e kryer KVK i shqiptoi një gjobë Shoqatës për mbrojtjen e të drejtave të autorit të muzikës ZAMP në vlerë prej 2.039.126,00 denarë dhe
- Asociacioni për menaxhimin kolektiv ndërkombëtar me të drejtat e veprave audio-vizuale AGICOA si një organizatë e vetme në treg për menaxhimin kolektiv të së drejtës për ritransmetimin kabllor të veprave audio-vizuale (për prodhuesit e filmave) në territorin e Republikës së Maqedonisë ka një pozitë dominuese dhe e ka keqpërdorur atë në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2015, në mënyrë që me dispozitën e nenit 8 të *Marrëveshjes për licencë në lidhje me licencën për ritransmetim të njëkohshëm dhe të pakufizuar të programeve dhe kanaleve televizive të cilat nuk janë EBU dhe VG Media e operatorit ADSL / IPTV dhe operatorëve kabllorë në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2011-2015*, dhënien e një zbritje të caktuar në kompensimin e licencës për ritransmetimin e programeve dhe veprave të përfaqësuara nga AGICOA e lidh atë me përfundimin paraprak të



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Marrëveshjes së Përgjithshme të Licencës në lidhje me lejen për një ritransmetim të njëkohshëm, të pandryshuar dhe të pakufizuar të programeve televizive që janë në koordinimin kabllor të EBU-së, VG Media Gesellschaft dhe RTL përmes rrjetit ADSL / IPTV dhe rrjetit kabllor në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2011-2015, me të cilën ka kryer një kundërvajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 2) në lidhje me nenin 11 të LMK-së. Për kundërvajtjen e kryer KVK-ja i shqiptoi një gjobë Asociacionit për menaxhimin kolektiv ndërkombëtar me të drejtat e veprave audio-vizuale AGICO në shumën prej prej 4.541.700,00 denarë. Kundër këtij vendimi të lartpërmendur u ngrit një padi në Gjykatën Administrative.

- Vendimi PK nr. 09-16/ më 28.03.2016**, me të cilin KVK në procedurën kundërvajtës konstaton që Shoqëria aksionare Makedonski Telekom për komunikime elektronike Shkup si një kompani që ka një pozitë dominuese në treg për ofrimin e shërbimeve fikse të telekomunikacionit për përdoruesit përfundimtar në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe të njëjtën e ka keqpërdor në një mënyrë që për modele tarifore të caktuara (edhe atë në pjesën e „ shërbimeve telefonike” pika 3 „, tarifa e bisedave të realizuara” nën pikën 3.2.1. „thirrjet për rrjetet celulare, çmimi për një minutë bisedë” dhe modeleve tarifor: „ Call Start modeli tarifor për linjë telefonike me 1 kanal zanor”, „Call & Surf Start”, „Call & Surf Comfort”, „” Max Start”, „ 2 Max Comfort”, 3 Max Start”, dhe „ 3 Max Comfort), konsumatorëve të tyre në mënyrë të pajustificueshme u ka paguar çmim të ndryshëm për thirrjet për abonentët e VIP OPERATOR SHPKNJP Shkup dhe “ ONE” Shërbime të telekomunikacionit SHPKNJP- Shkup në kushtet kur VIP OPERATOR SHPKNJP Shkup dhe “ ONE” Shërbime të telekomunikacionit SHPKNJP- Shkup, kishin çmime të rregulluara identike me shumicë për të përfunduar një thirrje prej 4.0 MKD/min, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë ka imponuar në çmimet e shitjeve të padrejta, që paraqet një kundërvajtje të nenit 59 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së. Për kundërvajtjen e kryer, KVK-ja ka shqiptuar një gjobë Shoqërisë aksionare Makedonski Telekom për komunikime elektronike Shkup në shumë prej 1.783.500,00 denarë. Vendimi i lartpërmendur është përfundimtar dhe ekzekutiv dhe ndaj të njejtës është vepruar.

Në vitin 2016, KVK miratoi 2 vendime në procedurën e kundërvajtjes për kundërvajtje më të lehta, si në vijim:

- Vendimi PK nr. 09-9/ 11 më 22.04.2016**, me të cilën KVK në procedurë, të iniciuar sipas detyrës zyrtare konstaton se Shoqëria për prodhim, ndërtim, tregti, trafik dhe shërbime RIFAM SHPK eksport-import Gostivar, nuk ka vepruar sipas konkluzionit të Komisionit për dorëzimin e të dhënave brenda afatit të përcaktuar dhe në kuptim të nenit 49 të LMK-së, në një mënyrë që nuk ka dorëzuar të dhënat e kërkuara brenda afatit të përcaktuar prej 15 ditësh, i cili zgjati deri më 01.01.2016, me të cilin është kryer një kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) e LMK-së, dhe për këtë i shqiptohet një gjobë në shumën prej 12.000.00 denarë. Vendimi i lartpërmendur është përfundimtar dhe ekzekutiv dhe ndaj të njejtës është vepruar.
- Vendimi PK nr. 09-23 më 15.06.2016** me të cilën KVK ka konstatuar se:
 - Shoqata e Mjekëve Privatë të Republikës së Maqedonisë, rr. Naroden front nr. 21 Shkup, me EMBS 5149541 i përfaqësuar nga Grozdanço Sutinov avokat i autorizuar nga Velezi, si shoqatë e ndërmarrjeve në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) alineja 1 dhe 2 të LMK-së,



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



- nuk kanë vepruar sipas konkluzionit të Sekretarit Gjeneral të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 07-251 / 1 prej 06.10.2014, për dorëzimin e të dhënave brenda afatit të caktuar, dhe në kuptim të nenit 48 dhe 49, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin në fjalë në afatin e përcaktuar prej tetë ditësh, i cili afat skadoi më 16.10.2014, si ditë deri kur Shoqata e Mjekëve Privatë të Republikës së Maqedonisë ishte e obliguar të dorëzonte të dhënat e kërkuara, me të cilin është kryer një kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) e LMK-së, dhe për kryerësin e kundërvajtjes Shoqatës së mjekëve privatë të Republikës së Maqedonisë, i shqiptohet një sanksion - gjobë në shumë prej 52.300,00 denarë.
2. Shoqata e Mjekëve Privatë të Republikës së Maqedonisë, rr. Naroden front nr. 21 Shkup, me EMBS 5149541 i përfaqësuar nga Grozdanço Sutinov avokat i autorizuar nga Velezi, si shoqatë e ndërmarrjeve në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) alineja 1 dhe 2 të LMK-së ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 145/10, 136/11 dhe 41/14), duke vepruar në bazë të Konkluzionit për fillimin e procedurës kundërvajtës të Komisionit për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 09-18 / 2 të datës 27.07.2015 me të cilin është kërkuar dorëzimi i të dhënave në kuptim të nenit 40 të LMK-së, me shkresë nr. 09-18/3 datë 17.09.2015, kanë dorëzuar të dhëna jo të plota, respektivisht të dhëna të cilat mund të mashtrojnë Komisionin për vendimmarrje për kundërvajtje pranë komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës, në mënyrën që nuk kanë dorëzuar Listën e çmimeve për shërbimet për pacientët privatë (ku lista e çmimeve fillon me: një certifikatë mjekësore për punë 1500, oo den), dhe gjithashtu nuk ka dorëzuar Listën e Çmimeve prej vitit 2008, me të cilin është kryer një kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) e LMK-së, dhe për kryerësin e kundërvajtjes Shoqatës së mjekëve privatë të Republikës së Maqedonisë, i shqiptohet një sanksion - gjobë në shumë prej 52.300,00 denarë. Sipas vendimit të lartpërmendur është ngritur një padi në Gjykatën Administrative.

2.4 Vlerësimi i përqendrimeve të ndërmarrjeve

Kapitulli i tretë i LMK-së i referohet kontrollit të përqendrimeve.

Në bazë të LMK-së pjesëmarrësit në përqendrim (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrësit) janë të obliguar ta njoftojnë Komisionin në qoftë se ndodh ndryshim në kontrollin në bazë afat-gjatë dhe në qoftë se:

1. Të ardhurat e përbashkëta dhe të përgjithshme vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse që u realizuan me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun botërorë, e tejkalon shumë prej 10 milion euro në kundërvlerë të denarit, bazuar në kursin valutor në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, që u realizua gjatë vitit afarist para zbatimit të përqendrimit, ku të paktën njëri prej pjesëmarrësve duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë ose
2. të ardhurat e përbashkëta dhe të përgjithshme vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse që u realizuan me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në Republikën e Maqedonisë, e tejkalon shumë prej 2,5 milion euro në kundërvlerë të denarit, bazuar në kursin valutor në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, që u realizua gjatë vitit afarist para zbatimit të përqendrimit ose
3. pjesëmarrja në treg e njërit prej pjesëmarrësve është më shumë se 40% ose pjesëmarrja e përgjithshme e pjesëmarrësve në treg është më shumë se 60% në vitin para zbatimit të përqendrimit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Komisioni vlerëson përqendrimit e paraqitura dhe miraton një vendim duke konstatuar që përqendrimi i paraqitur është në përputhje ose jo me LMK-në.

Në vitin 2016, në Komision u parashtruan 37 njoftime për përqendrim. Në vitin 2016, Komisioni miratoi 31 vendime.

Procedurat në lidhje me njoftimet e parashtruara të përqendrimeve

Numri i njoftimeve të parashtruara	37
Vendimet e miratuara-gjithsej	31
- Përqendrimit e miratuara pa kusht (është në përputhje me LMK-në)	30
- Përqendrimit e miratuara me kusht	/
- Përqendrimit e ndaluara (nuk është në përputhje me LMK-në)	/
- Përqendrimi nuk bie nën dispozitat e LMK-së	/
- Vendimet e anuluar që paraprakisht është lejuar përqendrimi	/
Njoftimi i përqendrimit është i paplotë dhe me vendim e njëjta refuzohet.	1

Në 30 vendimet është konstatuar që përqendrimi edhe pse bie nën dispozitat e LMK-së, ajo nuk do të ketë si pasojë të konsiderueshme parandalimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg, ose një pjesë esenciale të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose përforcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e LMK-së, ndërsa në një vendim konstatohet se njoftimi për përqendrim nuk është i plotë dhe sipas nenit 39 paragrafi (3) të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), është refuzuar.

Vendimet e Komisionit janë si më poshtë:

1. **Vendimi PA. nr. 08-82 më 26.01.2016** për përqendrimin me të cilin Figaro BidKo Limited (Figaro BidCo Limited), Londër, EC4A 3AE, Mbretëria e Bashkuar është një kompani me qëllim të veçantë, përfundimisht nën kontrollin e KKR dhe Ko LP. (KKR & CO. LP) Wilmington, Country of New Castle., Delaware 19801, United States of America, synon të fiton kontrollin e drejtpërdrejt të vetëm mbi LGC Sajens Grup Limited (LGC Science Group Limited), Mbretëria e Bashkuar, nëpërmjet shitjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e standardeve (të cilat përfshijnë shitjen e materialeve referuese dhe shërbimet e testimit profesional (proficiency testing), tregun e gjenomikës dhe tregun e laboratorëve dhe shërbimeve të menaxhuara.

2. **Vendimi PA. nr. 08-83. më 26.01.2016** për përqendrimin me të cilin METAL-NET SHPK import-eksport Kumanovë dhe kompania për ndërtim dhe tregti Kvalitet - SHPKNJP import-eksport Kumanovë do të fitojë kontroll të përbashkët mbi AD për tregtinë e brendshme dhe të jashtme AGROKUMANOVO Kumanovë, në bazë të shitblerjes së aksioneve.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun me shumicë me mallra metalike, tuba, pajisje dhe pajisje për ujësjellës dhe ngrohje qendrore.

3. **Vendimi PA. nr. 08-5 më 26.01.2016** për përqendrim ndërmjet me të cilin Evropiski Arkitektonski Sistemi S.a.r.l. (European Architectural Systems S.à r.l.) Luxembourg fiton kontroll të vetëm të drejtpërdrejtë mbi TRIMO inzhenering in proizvodnja montazhnih objektov d.d. (TRIMO inzeniring in proizvodnja montaznih objektov d.d) Trebnje, Slloveni, përmes shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në koncentrim janë aktivë në treg për shitjen e paneleve të kulmit dhe fasadave.

4. **Vendimi PA. nr. 08-7 më 01.02.2016** për përqendrim me të cilin Petrol Sllovenska energetska druzhba dd Ljubljana, Slloveni, ka për qëllim të fitojë kontroll mbi kompaninë Geoplino doo Ljubljana, kompani për tregtimin dhe transportin e gazit natyror, Lubjanë, Slloveni, nëpërmjet blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e furnizimit me energji dhe tregti, përfaqësimit dhe ndërhyrjes në tregun e gazit natyror.

5. **Vendimi PA. nr. 08-1 më 01.02.2016** për përqendrim me të cilin Teva farmaceutikal Industris Limited, Izrael do të fitojë kontroll mbi biznesin global gjenerik të Allergan Plc, Irlandë. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së ilaçeve.

6. **Vendimi PA. nr. 08-6 më 25.02.2016** për përqendrim me të cilin AD IMLEK BELGRAD (AD IMLEK BEOGRAD) Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të plotë mbi Nishka mlepara doo Nis (Niska mlepara doo Nis) përmes blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shitjeve të qumështit, tregun e shitjeve të produkteve të kosit, në tregun e shitjes së ajkës dhe tregut për shitjen e djathit.

7. **Vendimi PA. nr. 08-20 më 29.03.2016** për përqendrim me të cilin AMADEUS IT GROUP S.A., Madrid, Spanjë do të fitojë kontrollin e AMADEUS SLOVENIA Kompania për marketing d.o.o., Lubjanë-Slloveni dhe mbi Kompaninë për komunikime, tregti dhe shërbime NMC SHPK Shkup në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e sigurimit të shërbimeve lidhur me kërkimin, pagesën, rezervimet, regjistrimin (booking), dhënien e biletave dhe shërbimeve të tjera të procesit në kohë reale për shërbimet e udhëtarëve dhe agjencitë e udhëtimit në lidhje me biletat e avionëve.

8. **Vendimi PA. nr. 08-25 më 29.03.2016** për përqendrim me të cilin Ingram Mikro Inc., Irvin, Kalifornia 92612-0697, SHBA synojnë të marrin kontrollin e RRC Polska Sp.z.o.o Varshavë, Poloni në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun me shumicë me kompjuterë, pajisje kompjuterike periferike dhe softuer.

9. **Vendimi PA. nr. 08-26 më 08.04.2016** për përqendrim me të cilin ORBIKO SHPK për Tregti Zagreb, Republika e Kroacisë tregtisë Zagreb me seli në Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë synon të fitojë kontroll mbi Optimum Distribucija CZ dhe SK s.r.o Pragë 10, Republika Çeke dhe mbi Optimum Distribucija sp.zo.o Varshavë, Republika e Polonisë, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shitjes me shumicë.

10. **Vendimi PA. nr. 08-19 më 08.04.2016** për përqendrim me të cilin Novomatik AD (Novomatic AG), Gumpoldskirchen, Austri, fiton kontroll mbi Kazinos Austria AD (Casinos Austria Aktiengesellschaft), Vjenë Austri, nëpërmjet blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e lojërave të fatit dhe aktiviteteteve të basteve.

11. **Vendimi PA. nr. 08-22 më 08.04.2016** për përqendrim me të cilin Silk Road Capital AG, (Silk Road Capital AG) Cyrih - Kisnaht, Zvicër fiton kontroll të drejtpërdrejtë mbi Alpha Banka SHA Shkup, përmes shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shërbimeve bankare.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



12. **Vendimi PA. nr. 08-36 më 13.06.2016** për përqendrim me të cilin Agri Food Invest S.a.r.l., Luksemburg, Principata e Madhe në Luksemburg fiton kontrollin mbi BONUM SHPKNJP import-eksport Shkup, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e përpunimit dhe konservimit të pemëve dhe perimeve.
13. **Vendimi PA. nr. 08-32 më 13.06.2016** për përqendrim me të cilin LSREF4 Eagle Luksemburg S.a.r.l., Luksemburg fiton kontrollin mbi Centris Rial Estejt GmbH, Vjenë, Austri, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit janë aktivë në tregun e dhënies dhe menaxhimit të pasurive të patundshme të veta ose pasurive ta patundshme të marra me qira (lizing).
14. **Vendimi PA. nr. 08-34 më 13.06.2016** për përqendrim me të cilin Juan Jing ICE Co limited (Yuan Jing ICE Co., Limited), Hong Kong do të fitojë kontrollin e Internacional Currency Ekschange Limited (International Currency Exchange Limited), Londër V1D 7ED, Lenlin U.K. Limited(Lenlyn U.K. Limited), Londër V1D 7ED, Ekschange Corporation (Europe) Limited (Exchange Corporation (Europe) Limited), Londër V1D 7ED dhe Hoopoe Investments Limited (Hoopoe Investments Limited, Londër V1D 7ED, nëpërmjet shitjes së kapitalit aksionar. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shërbimeve të këmbimit valutor.
15. **Vendimi PA. nr. 08-31 më 13.06.2016** për përqendrim me të cilin Telemah "d.o.o. Ilixha-Saraevo („Telemach“ d.o.o. Ilidža-Sarajevo), , Ilixha-Saraevo, Bosnje dhe Hercegovinë do të fitojnë kontroll mbi kompaninë tregtare "Global Internet" d.o.o. Novi Travnik ("Global Internet" doo Novi Travnik), Novi Travnik, Bosnje dhe Hercegovinë, përmes blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacionit.
16. **Vendimi PA. nr. 08-33 më 13.06.2016** për përqendrim me të cilin Grin Holdings Limited (Gren Holdings Limited), Nikozia, Qipro synon të marrë kontrollin e Romgrin Universal Limited (Romgreen Universal Limited), Nikozia, Qipro, nëpërmjet blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e grumbullimit, riciklimit dhe përpunimit të mbeturinave prejplastike .
17. **Vendimi PA. nr. 08-28 më 13.06.2016** për një përqendrim që do të ndodhë nëpërmjet formimit të një ndërmarrjeje të përbashkët ndërmjet Nestle SA, Zvicër në lidhje me biznesin e tij të akullores dhe disa ushqime të ngrira në Evropë, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut ("EMENA") (me përjashtim të Izraelit) dhe disa zona të tjera gjeografike, si dhe biznesin e tij për produktet e qumështit të ftohtë në Filipine dhe PAI Partners SAS, Francë në lidhje me investimet e tyre në R&R Ajs Crimea Plc, Nortallerton, Nort Jorkshir, DL7 9UL, Mbretëria e Bashkuar. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së akullores.
18. **Vendimi PA. nr. 08-30 më 24.06.2016** për përqendrim me të cilin Hi Stil Grup, Ko, Ltd (He Steel Group, Co., Ltd.) do të marrë kontrollin mbi Zhelezara Smederevo, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pronës. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së çelikut.
19. **Vendimi PA. nr. 08-38 më 05.08.2016** për përqendrim me të cilin Hemofarm a.d. Vrshac (Hemofarma.d. Vršac) Vrshac, Republika e Serbisë, nga kompania Ivançiq dhe djemtë d.o.o. Beograd, Republika e Serbisë, merr përsipër një pronë të caktuar, domethënë operacion, kështu pronësia e lartpërmendur, dmth operacioni, fiton kontroll të pavarur. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së produkteve farmaceutike.
20. **Vendimi PA. nr. 08-39 më 05.08.2016** për përqendrim me të cilin Çajna NESHENAL AGROKEMIKAL KORPOREJSHN (CHINA NATIONAL AGROCHEMICAL CORPORATION), Peking, NR Kinë fiton kontroll mbi SINGENTA AG, (SYNGENTA AG),



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Basel, Zvicër, përmes një oferte publike të aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e herbicideve selektive, në tregun e insekticideve dhe në tregun e fungicideve.

21. **Vendimi PA. nr. 08-41 më 06.09.2016** për përqendrim me të cilin Hajsted Limited, Londër, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda Veriore do të fitojë kontroll mbi kompaninë tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime BALFIN MK SHPKNJ import-eksport Shkup, me anë të blerjes së një aksioni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e marrjes me qira të lokaleve afariste.

22. **Vendimi PA. nr. 08-44 më 03.10.2016** për përqendrim që ka të bëjë me marrjen e kontrollit të përbashkët nga GRVC Holdings Limited (GRWC Holdings Limited), Nikozia, Qipro dhe z.Boguslav Kovalski, shtetas i Republikës së Polonisë, mbi kompaninë Gral SA. (Graal S.A.), Vejherovo, Poloni nëpërmjet një kompanie me qëllim të veçantë Grinviç Investments Sp. z o.o. (Greenwich Investments sp. Z oo), Varshavë, Republika e Polonisë. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në treg për shitjen me shumicë të peshkut të konservuar dhe ushqimeve të tjera të detit.

23. **Vendimi PA. nr. 08-43 më 03.10.2016** për përqendrim me të cilin KPNK Kooperatif U.A. (KPNK Coöperatief U.A.) Amsterdam, Holandë dhe Kopernikus Korporejshn B.V. (Kopernikus Corporation B.V.) Amsterdam, Holandë fitojnë kontroll të përbashkët mbi kompaninë Kopernikus Tehnologhi d.o.o. Beograd (Kopernikus Technology d.o.o. Beograd), Novi Beograd, Republika e Serbisë, me blerjen e një aksioni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shërbimeve për shpërndarjen e përmbajtjes së medias.

24. **Vendimi PA. nr. 08-46 më 03.10.2016** për përqendrim me të cilin Mosburger GmbH, Vjenë, Republika e Austrisë, mbi operacionet për prodhimin e dërrasave dhe paketimin prej kartoni e cila do të transferohen në një kompani të sapo themeluar në Republikën e Turqisë, nga kompanitë Turkie Shishe Xham Fabrikalere A.D. (Türkiye Şişe ve Cam Fabrikaları A.) dhe Pashabahçe Xham Sanaji Ve A.D. (Paşabahçe Cam Sanayi ve Ticaret A.Ş.), Stamboll, Turqi, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve në kompaninë e sapo themeluar nga Mosburger GmbH, që i takon Grupit Princhor. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në treg për prodhimin e dërrasave dhe ambalazheve të bërë prej kartoni.

25. **Vendimi PA. nr. 08-45 më 03.10.2016** për përqendrim me të cilin Srbija Brodbend-Srpske kablovske mrezhe d.o.o. (Serbia Broadband – Srpske kablovske mreže d.o.o. Beograd), Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi Rrjetet e Unifikuara të Kablllove Interaktiv – I.KOM d.o.o. (Interaktivne kablovske objedinjene mreže – I.KOM d.o.o), Nov Belgrad, Republika e Serbisë, nëpërmjet blerjes së aksionit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacionit.

26. **Vendimi PA. nr. 08-47 më 17.10.2016** për përqendrim me të cilin MLS Co. Ltd. (MLS Co. Ltd) do të fitojë një kontroll të pavarur mbi Ledvans GmbH (Ledvance GmbH) nga Gjermania dhe mbi kompaninë Ledvans LLC, (Ledvance LLC), Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke blerë 100% të aksioneve të tyre. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e llambave për përdorim të përgjithshëm.

27. **Vendimi PA. nr. 08-40 më 17.11.2016** për përqendrim me të cilin ORBIKO SHPK për tregti, Zagreb Republika e Kroacisë do të marrë kontrollin mbi EVERET INTERNESHNAL,, shoqata ndërkombëtare e Tregtisë d.o.o. Lubjanë, Slloveni, me anë të blerjes së një aksioni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shitjes së parfumeve, kozmetikës dhe produkteve për përkujdesje.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



28. **Vendimi PA. nr. 08-50 më 17.11.2016** për përqendrim me të cilin Tixharet Anonim Shirketi, Stamboll, Turqi do të fitojë kontroll mbi Kompall Elektroniks Europe Sp. z. o.o. (Compal Electronics Europe Sp. z o.o.) Poloni, me anë të blerjes së një aksioni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së televizorëve.
29. **Vendimi PA. nr. 08-51 më 28.11.2016** për përqendrim me të cilin Hemofarm a.d. Vrshac (Hemofarm a.d. Vršac) Vrshac, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi Veleksfarm d.o.o. Beograd, Republika e Serbisë, nëpërmjet fitimit të një aksioni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit dhe shitjes së barnave..
30. **Vendimi PA nr. 08-52 më 28.11.2016** për përqendrim me të cilin SB Telekom Limited(SB Telecom Limited), Nikozia, Qipro do të fitojë kontroll mbi kompaninë IOOO Alternativnaja Cifrovaja Set, (IOOO Alternativnaya Tsifrovaya Set), Minsk, Republikën e Bjellorusisë dhe dhe kontrollin e tërthortë të drejtpërdrejtë mbi OOO TeleSet (OOO TeleSet), g.Gomel, fusha Gomelskaja , Republika e Bjellorusisë, nëpërmjet blerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacionit.
31. **Vendimi PA nr. 08-54 më 06.12.2016** për përqendrim me të cilin Ulisse Investissment S.A., nga Apia, Samoa si parashtues i njoftimit, njofton Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës se do të marrë kontrollin mbi kompaninë Moiooman Propertis Ltd, Tortola, Ishujt e Virgjër Britanikë, nuk përmban një Çertifikatë nga Regjistri për Ulisse Investissment S.A. , një dokument që detyrimisht dorëzohet në Njoftimin e përqendrimit, në përputhje me nenin 15 paragrafi (4) pika 3) të LMK-së, për shkak të së cilës Njoftimi i Përqendrimit është i paplotë dhe në pajtim me nenin 39 paragrafi (3) të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, refuzohet.

2.5. Bashkëpunimi i Komisionit me trupat rregullator dhe organet tjera shtetërore

Sipas LMK-së, Komisioni gjatë zbatimit të detyrave që janë në kompetencë të tij, bashkëpunon me organet e tjera shtetërore për çështjet që kanë të bëjnë me Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Komisioni dhe trupat rregullator janë të detyruar të shkëmbejnë të dhëna dhe informacione që ato kanë nevojë për ty kryer detyrat që janë në kompetencë të tij, ku vëllimi i shkëmbimit të informacionit është i kufizuar me të dhënat dhe informacionet të cilat janë përkatëse dhe proporcionale me qëllimet e shkëmbimit.

Në vitin 2016, Komisioni vazhdoi bashkëpunimin e suksesshëm me: Komisionin Rregullator për Energjetikë, Agjencinë për komunikime elektronike, Byronë për furnizime publike, Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor dhe Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale.). Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet kontakteve të rregullta në kuadër të këshillave për bashkëpunim që janë parashikuara me memorandumet për bashkëpunim dhe përmes bashkëpunimit të ngushtë për lëndët të cilët janë në rrjedhë dhe që janë në kompetencë të komisionit, gjegjësisht Trupave rregullator, të cilët kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme për zhvillim e konkurrencës në sektorët përkatës rregullator.

2.6 Mendimet e dhëna nga Komisioni

Komisioni , në pajtim me LMK-në, jep mendime për projektligjet dhe aktet tjera me të cilin rregullohen çështjet që lidhen me aktivitetin ekonomik, dhe të cilët mund të kenë ndikim në konkurrencën e tregut. Në drejtim të realizimit të këtij autorizimi si dhe në përforcimin e



REPUBLIKA E MAQEDONISË KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



bashkëpunimit ndërmjet resorëve me organet kompetente në RM, Komisioni paraqiti mendimin e tij nëpërmjet:

- Mendim mbi draft dokumentin për analizën e tregut 1- Qasje në një rrjet publik të komunikimeve elektronike në një vend të caktuar për përdoruesit rezident dhe të biznesit;
 - mendimi mbi draft dokumentin për një analizë të tretë të tregut për Qasjen fizike në Infrastrukturën e Rrjetit (qasje e plotë dhe qasje e thyeshme e ndarë) në një vend të caktuar dhe analiza e katërt e tregut për shërbimet me një gamë të gjerë.
 - mendimi mbi draft dokumentin për analizës e tregut 11 - shërbimet për qasje në rrjetet publike të komunikimit celular dhe shërbimet për fillimin e një thirrjeje në rrjetet publike të komunikimeve celulare.
 - mendimi në lidhje me blerjen e Fabrikës së Automjeteve Hekurudhorë Kolska Veles nga Transportit Hekurudhor i Maqedonisë SHA Shkup.
- Komisioni edhe në vitin 2016, ka bashkëpunuar vazhdimisht me Komisionin Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në fushën e hartimit të akteve nënligjore në pajtim me Ligjin për Energjetikë.

3. TRANSPARENCA

Në mënyrë që të siguroj transparencë në punën e tij, Komisioni të gjitha vendimet e tija të plotfuqishme i publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e Komisionit. Ueb faqja e Komisionit në mënyrë të rregullt azhurnohet.

Komisioni ndërmerr aktivitete me të cilat rrit ndërgjegjshmërinë për nevojën e mbrojtjes së Konkurrencës, duke marrë pjesë në konferenca nacionale, tryeza të rumbullakëta, në informimin e medieve për punën e tij etj.

B. NDIHMA SHETËRORE

4. Korniza juridike

Kornizën juridike në kontrollin e ndihmës shtetërore e përbën Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe aktet nënligjore të cilat janë të nevojshme në zbatimin e saj.

4.1 Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Më 28 tetor 2010, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi një Ligj të ri për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10). Ligji hyri në fuqi më 13.11.2010.

Me miratimin e ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore u bë harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit të Maqedonisë në këtë fushë me legjislacionin e UE-së, duke përfshirë: nenet 107-109 të Marrëveshjes së funksionimit të UE-së dhe Rregulloret e UE-së 32001R0069 dhe 31999R0659. Në të njëjtën kohë është rritur ligjshmëria dhe efikasiteti i veprimeve të Komisionit nëpërmjet harmonizimit të dispozitave të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo mundëson një procedurë më të thjeshtë



REPUBLIKA E MAQEDONISË

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



administrative para Komisionit, në çështjet që lidhen me ndihmën shtetërore, procedura e cila do të jetë më e qartë dhe më transparente për të gjitha palët e interesuara.

4.2 Aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Përveç miratimit të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 141/11) dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e parashtrimit të njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore dhe procedura për mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore ekzistuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 142/11), në vitin 2013 u miratua Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 109/13), si dhe Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale (në seancën e Qeverisë e mbajtur më 30.12.2013 dhe e njëjta është publikuar në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 03/14).

Me miratimin e Rregullores për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale rregullohen në mënyrë të detajuar kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale. Njëkohësisht, rregullohen çështjet që kanë një rëndësi të veçantë për vlerësimin efektiv mbi ndarjen e planifikuar të ndihmës regjionale, si dhe për kushtet dhe procedurën për ndarjen e të njëjtës në Republikën Maqedonisë nga ana e Komisionit. E njëjta është në harmonizim me legjislacionin evropian në fushën e ndarjes së ndihmës regjionale. Me këtë Rregullore precizohen kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale, e cila është e rëndësishme për vlerësimin e drejtë dhe në kohë të lejueshmërisë ose pa lejueshmërisë për ndarjen e të njëjtës, dhe në këtë mënyrë do të mundësohet një zbatim efikas i kompetencave të Komisionit gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të ndarjes së ndihmës regjionale shtetërore. Miratimi i Rregullores është bërë me qëllim të harmonizimit të kushteve dhe procedurës për ndarjen e ndihmës regjionale me kërkesat e UE *acquis*.

Komisioni vazhdon me harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit evropian me miratimin e Rregullores për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës horizontale. Me këtë Rregullore rregullohen çështjet që kanë një rëndësi të veçantë për vlerësimin efektiv të ndarjes së planifikuar të ndihmës horizontale, si dhe për kushtet dhe procedurën për ndarjen e të njëjtës në Republikën e Maqedonisë nga ana e Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës shtetërore në fushat e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit, mbrojtjen e ambientit jetësor, punësimit, trajnimit, ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në çfarëdo forme, duke përfshirë edhe formën e kapitalit të rrezikut, e cila është me rëndësi në vlerësimin e drejtë dhe në kohë të dhënies leje ose jo të ndarjes së ndihmës në këto fusha. Në këtë mënyrë arrihet një shkallë më e lartë e harmonizimit të legjislacionit të Maqedonisë me UE *acquis* në fushën e ndihmës shtetërore. Miratimi i Rregullores është bërë me qëllim të harmonizimit të kushteve dhe procedurës për ndarjen e ndihmës regjionale me kërkesat e UE *acquis*.

Me miratimin e këtyre rregulloreve nuk vlen më Rregullorja për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e republikës së Maqedonisë” nr. 157/7) dhe Rregullorja për përcaktimin e kushteve dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e republikës së Maqedonisë” nr. 81/03 dhe 118/09).

Komisioni do të vazhdojë harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit të ndihmës shtetërore me legjislacionin e ndihmës shtetërore të BE-së.

5. Parimet metodologjike

5.1. Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Baza metodologjike e ndihmës shtetërore është vendosur me ligjin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/03, 70/06, dhe 55/07) dhe akteve nënligjore, dhe është



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



plotësuar edhe me Ligjin për Kontrollin e Ndhmës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10).

Gjatë analizës dhe vlerësimit të të dhënave të paraqitura në rastet e mundshme të ndihmës shtetërore, Komisioni edhe më tutje i merr parasysh kriteret themelore të cilët e definojnë ndihmën shtetërore edhe atë nëse:

- bëhet fjalë për masat të cilët përfshijnë transferim të mjeteve shtetërore (duke përfshirë ato nacionale dhe lokale),
- ndihma e dhënë paraqet përparësi ekonomike për marrësin e ndihmës,
- ndihma e dhënë është selektive dhe
- ndihma ka një ndikim në konkurrencë dhe në tregti.

Sipas nenin 6 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), dhënës i ndihmës shtetërore është Qeveria e Republikës së Maqedonisë, organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe çdo organ apo person juridik tjetër, të cilat ndajnë ose planifikojnë të ndajnë ndihmën shtetërore.

Në përcaktimin e instrumenteve financiare janë marrë parasysh grupet e mëposhtme:

- Instrumentet në grupin A, të cilët ndahen në dy nëngrupe, ku në nëngrupin A1, përfshihen mjetet e pakthyeshme në formën e dotacioneve, subvencioneve me kamata, shlyerjet e borxheve të ndërmarrjeve të biznesit nga kreditë, pagimi për shlyerje të detyrueshme të borxhit, ndërsa në nëngrupet A2, hyn lehtësimi dhe lirimi nga pagesa e taksave dhe kontributeve të sigurimit social;
- Instrumentet në grupin B, në të cilin përfshihen transferimet financiare të shtetit në formë të investimeve kapitale. Në këtë grup përveç investimeve kapitale klasike, përfshihen edhe konvertimet e kërkesave të pjesëmarrjes në kapital dhe shitjen e volitshme të pronës shtetërore;
- Instrumentet në grupin C, në të cilin përfshihen të gjitha transferimet në të cilin elementi i ndihmës shtetërore paraqet një përfitim të interesit. Këtë transfero janë ose huazime të volitshme (grupi C1) ose pagesë e shtyrë e tatimeve me interes më të ulët (grupi C2);
- Instrumentet në grupin D, në të cilin përfshihen garancitë si një sigurim që vinë nga rreziku komercial ose jo komercial.

6. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës edhe në vitin 2016, vazhdon me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, sidomos me obligimin që rrjedh nga neni 13 i Ligjit në të cilin parashihen të gjitha dhënësit e ndihmës shtetërore (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe çdo organ apo person juridik tjetër, të cilat ndajnë ose planifikojnë të ndajnë ndihmën shtetërore) deri te Komisioni të paraqesin njoftim për çdo plan të ndarjes së re ose ndryshim të ndihmës ekzistuese shtetërore, si dhe për ndalesën që ndihma e planifikuar shtetërore ti ndahet shfrytëzuesit në periudhën derisa Komisioni nuk ka miratuar një vendim të tij ose derisa të skadojë afati, në të cilin Komisioni duhet të miratoj një vendim për vlerësimin e ndihmës. Po ashtu, Komisioni u tregonte të gjithë dhënësve të ndihmës shtetërore për detyrimin që buron nga neni 24 i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore sipas të cilit çdo dhënës i ndihmës shtetërore është i detyruar që më së voni deri më 31 mars të vitit vijues, ti dorëzoj Komisionit një raport vjetor për ndihmën e lejuar të ndarë shtetërore për vitin paraprak dhe për detyrimin e të njëjtit nen, për çdo dhënës dhe shfrytëzues të ndihmës



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



shtetërore të mbajë evidencë të saktë për ndihmën e ndarë gjegjësisht për ndihmën e marrë shtetërore, si dhe për ndihmën e ndarë gjegjësisht ndihmën e marrë me rëndësi të vogël (de minimis).

6.1 Vendimet/Aktvendimet e miratuara për ndihmën e ndarë shtetërore në vitin 2016

Në vitin 2016, numri i vendimeve të miratuara nga Komisioni është 13, ku në 10 (dhjetë) vendime u konstatua se masat e përfshira në njoftimet të dorëzuara në Komision nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore paraqesin ndihmë shtetërore në bazë të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), ndërsa te (1) një vendim, Komisioni konstatoi se masat e përfshirë në njoftim paraqesin ndihmë me rëndësi të vogël (ndihmë de minimis) respektivisht ndihma e ndarë e cila për një përdorues nuk kalon 200.000 euro për një periudhë prej tre vitesh, ndërsa me 2 vendime, Komisioni shpalli pavlefshmërinë e ndihmës shtetërore paraprakisht të planifikuar.

2016

	Numri i Vendimit	Dhënësi	Qëllimi	Shuma në denarë	Shuma në Euro
1	Vendimi nr. 10-12 i datës 28.01.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënia e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të XHONSON KONTROLS AUTOMOTIVE STROMICA SHPKNJP STRUMICË	/	/
2	Vendimi nr. 10-14 i datës 05.02.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënie e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të Haj Tek Asembli Centar SHPKNJP eksport-import Ilinden	/	/
3	Vendimi nr. 10-15 i datës 05.02.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënie e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të Van HOOL Makedonija SHPKNJP Ilinden	/	/
4	Vendimi nr. 10-17 i datës 10.02.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënie e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të FPC TEHNOPLAST SHPKNJP eksport-import Shkup	/	/



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



5	Vendimi nr. 10-79, datë 12.02.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënien e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të DELFI ELEKTRONIKS SISTEMS MAKEDONIJA SHPKNJP Shkup	/	/
6	Vendimi nr.10-27, datë 29.03.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministri pa Portofol Xheri Naumof	Dhënien e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të DPTU LUTEXH SHPKNJP Shkup	/	/
7	Vendimi nr.10-10, datë 20.04.2016 (de minimis) / ndihmë horizontale	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Plani operativ për programet aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2016	518.157.760 /159.080.000	8.425.329/ 2.586.667
8	Vendimi nr.10-35, datë 20.05.2016	Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit për vitin 2016	Programi për promovimin dhe mbështetjen e turizmit për vitin 216	136.000.000	2.211.382
9	Vendimi nr.10-27, datë 06.09.2016		Pavlefshmëria e Vendimit të Komisionit PA.nr.10-27 nga data 29.03.2016 me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kabineti i Ministrisë për Investimet e Huaja Xheri Naumof	/	/
10	Vendimi nr. 10-9 të datës 06.09.2016		Pavlefshmëria e Vendimit të Komisionit PA.nr.10-151 prej 31.01.2014 me kërkesë të Agjencisë për Investime të Huaja dhe Promovimin e Eksportit të Republikës së Maqedonisë.	/	/



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



11	Vendimi Nr. 10-49 të datës 10.10.2016	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	Programi për investime në mjedis jetësor për 2017	5.000.000	81.300
12	Vendimi nr. 10-64 të datës 27.12.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënia e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të KOSTAL Makedonija SHPKNJP Ohër	/	/
13	Vendimi nr. 10-63 të datës 27.12.2016	Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial	Dhënia e ndihmës shtetërore të planifikuar për zhvillimin rajonal të VITEK MAKEDONIJA SHPK Ilinden	/	/
Gjithsej				1.330.471.197	21.633.678

Të dhënat për vitin 2016, të paraqitura në tabelë, e tregojnë shumën totale të ndihmës shtetërore të planifikuar për vitin 2016, duke e paraqitur në kategori të ndryshme, të shprehura në denarë dhe euro².

Kategoritë për të cilat ndihma shtetërore është ndarë në vitin 2016 janë: turizmi, punësimi dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Në vitin 2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës miratoi vendime pas parashtrimit të Njoftimit për ndihmë të planifikuar shtetërore për zhvillim regjional nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore. Vendimet e këtilla, të treguara në tabelën e mësipërme, janë vendime të miratuara nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës për ndarje të planifikuar të ndihmës shtetërore regjionale, e cila si e tillë është në përputhje me qëllimet e politikës regjionale të Republikës së Maqedonisë, duke mbështetur investimet produktive fillestare ose hapjen e vendeve të reja të punës lidhur me investimet. Nga ajo që u tha mund të konstatohet se edhe në vitin 2016, vazhdon investimi i investitorëve të huaj në republikën e Maqedonisë, sidomos në zonat zhvillimore teknologjike industriale, me qëllim të përmirësimit, rritjes më të shpejt dhe zhvillimit ekonomik në vend.

Nga të dhënat e vitit 2016 mund të konkludohet se pjesëmarrja e ndihmës shtetërore në vitin 2016 krahasuar me BPV (vlerësimi nuk është final, sepse BPV final për vitin 2016 do të jetë gati në fund të vitit 2017) është 0,2%.

Shuma e përgjithshme e ndihmës shtetërore e cila është ndarë në këtë vit është **1.330.471.197** denarë. Kjo shumë është notifikuar nga dhënësit e ndihmës shtetërore dhe i lejuar nëpërmjet masave që Komisioni i miraton si ndihmë e dhënë e lejuar shtetërore, e cila plotësisht do të realizohet në vitet e ardhshme.

Gjithashtu, nga të dhënat e vitit 2016 mund të konkludojmë se me shumicën e dhënësve të ndihmës shtetërore është vendosur kontinuitet në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga implementimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore, dhe kjo mundëson vlerësimin e pandërprerë, kontrollin dhe mbikëqyrjen nga ana e Komisionit të ndihmës së tillë shtetërore në ato fusha.

² Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligjin për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, të dhënat individuale që janë sekret afarist nuk publikohen.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



6.2 Ndhimja shtetërore sipas instrumenteve

Në lidhje me instrumentet me të cilat është ndarë ndihma shtetërore për të cilën janë dorëzuara njoftime- notifikime dhe për të cilën është miratuar me një vendim nga Komisioni në periudhën 2016, mund të konkludohet se ndihma shtetërore e ndarë në vitin 2016, është ndarë nëpërmjet instrumenteve të grupit A.

6.3 Mendimet e Komisionit

Në vitin 2016, numri i mendimeve të dhëna nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është 20. Numri i madh i mendimeve të cilët Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i ka miratuar gjatë vitit 2016, është për shkak të nevojës së dhënësve të ndihmës shtetërore të marrin një mendim nga Komisioni qysh në fazën e përgatitjes së akteve nënligjore, të cilat në vetvete mund të përmbajnë elemente të ndihmës shtetërore, si dhe për nevojën e vlerësimit të propozim marrëveshjeve për ndarje të ndihmës regjionale shtetërore për shfrytëzuesit potencial.

7. Komentet dhe konkluzionet

Është i dukshëm trendi i kërkesës së vazhdueshme të mendimeve dhe njoftimeve të dorëzuara-notifikimeve që vijnë nga ministritë, që është një rezultat i rritjes së konsiderueshme të vetëdijes për rëndësinë që e ka kjo zonë, si një pjesë e rëndësishme e fushës së mbrojtjes së konkurrencës dhe ndryshimeve të paraqitura në legjislacion. Në të njëjtën kohë, Komisioni është në komunikim të vazhdueshëm jo formal me të gjithë dhënësit e ndihmës shtetërore që kanë nevojë për ndonjë informacion në lidhje me masat e planifikuara për ndarje të ndihmës shtetërore nga dhënësit. Gjithashtu, jo më pak i rëndësishëm është edhe zbatimi i drejtë i legjislacionit për ndihmë shtetërore për integrimet evropiane.

Të dhënat për ndihmën e ndarë shtetërore në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016, flasin se ndihma shtetërore në masë të madhe është ndarë për përkrahjen projekteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomin e shtetit, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të projekteve që nxisin zhvillimin ekonomik të zonave në Republikën e Maqedonisë, ku standardi i jetesës është i ulët ose ka papunësi të lartë. Domethënë, bëhet fjalë për ndihmën e ndarë shtetërore për zhvillim regjional me të cilën përkrahen investimet e huaja në vend, nëpërmjet subvencionimit të kompanive të cilat investojnë në Republikën e Maqedonisë.

Nga ana tjetër, përmes programeve të zhvillimit, shteti ka marrë pjesë nëpërmjet mekanizimit të ndihmës shtetërore në përkrahjen dhe zhvillimin e turizmit, ku si dhënës të ndihmës e hasim Agjencinë për promovim dhe përkrahje të turizmit. Gjithashtu, shteti përmes dhënies së ndihmës shtetërore ndihmoi edhe në një pjesë të masave në një pjesë të masave nga ana e Planit Operacional për programet aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2016, ku si dhënës paraqitet Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë. Në këtë kontekst, shteti nëpërmjet ndarjes së ndihmës shtetërore nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë, ndihmoi në mbrojtjen e mjedisit jetësorë nëpërmjet të zbatimit të masave konkrete, që janë pjesë përbërëse e Programit për Mbrojtjen e mjedisit jetësorë për vitin 2017.

Gjithashtu, duhet të theksohet edhe komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me dhënësit e ndihmës shtetërore që kanë për qëllim të ndajnë ndihmë regjionale në zonat zhvillimore teknologjike-industriale. Domethënë, të gjitha propozim- marrëveshjet për ndarje të ndihmës shtetërore të cilat lidhen ndërmjet shfrytëzuesit potencial të ndihmës shtetërore dhe dhënësit të ndihmës



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



shtetërore paraprakisht marrin pëlqimin e Komisionit, në lidhje me tekstin e të njëjtit, ndërsa në fushën e kompetencave nga ana e Komisionit.

Duhet të theksohet se në një numër të vogël të dhënësve të ndihmës shtetërore ende mungon kryerja e obligimeve për dorëzimin në kohë të raportit vjetor për ndihmën shtetërore të ndarë për vitin e kaluar, ku me këtë minohen mekanizmat e vendosura ligjore për mbikëqyrje. Komisioni, si një organ që merr përsipër mbikëqyrjen dhe kontrollin e ndihmës shtetërore, ndërmer aktivite për të kapërcyer këto probleme dhe pritet që në të ardhmen, bashkëpunimi me të gjithë dhënësit e ndihmës shtetërore të jetë në nivelin e kërkuar. Komisioni mirëpret dukurinë e thirrjeve të shpeshta të përfaqësuesve të Komisionit, në përgatitjen e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike.

Megjithatë, dhënësit e ndihmës shtetërore tregun gatishmëri, përmes konsultimeve me Komisionin në baza ditore, në kohë dhe saktësisht ti dorëzojnë njoftimet deri te Komisioni.

V. INTEGRIMI NË UE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në vijim janë përshkruar aktivitetet e Komisionit në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në vitin 2016, në lidhje me procesin përafrimit në Unionin Evropian, projektet për ndihmë teknike të Unionit Evropian në të cilat Komisioni është shfrytëzues, si dhe bashkëpunimi bilateral dhe multilateral dhe pjesëmarrja e punonjësve të Komisionit në seminare dhe konferenca ndërkombëtare.

8. Integrimi në UE

8.1 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2016 në fushën antitrust dhe ndihmën shtetërore

Rregullat e UE-së e mbrojnë konkurrencën e lirë. Këto përfshijnë rregullat antitrust kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet ndërmarrjeve dhe keqpërdorimit me pozitën dominuese. Rregullat e BE-së, gjithashtu i pengojnë qeveritë të ndajnë ndihmë shtetërore që e prishin konkurrencën.

Vendi është **përgatitur mesatarisht** në fushën e politikës së konkurrencës. **Nuk është bërë progres** në këtë fushë në periudhën kur është bërë raporti. Vendi është relativisht i avancuar në lidhje me harmonizimin ligjor, por përpjekje të rëndësishme janë të nevojshme për të zbatuar. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet veçanërisht të:

- Forcojë dosjen e zbatimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Komisioni)
- Rrisë transparencën e ndihmës shtetërore të dhënë nga Qeveria.

Antitrust dhe përqendrimet

Korniza ligjore është plotësisht në përputhje me nenin 101 (marrëveshjet kufizuese) dhe nenin 102 (keqpërdorimi i pozitës dominuese) të Marrëveshjes për themelimin e UE-së dhe të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit Ajo gjithashtu mbulon kontrollin ex ante (paraprak) të përqendrimeve, në përputhje me parimet e Rregullores së përqendrimeve. Disa zbrazëtira në legjislacionin sekondar duhet sa më parë të plotësohen.

Sa i përket kornizës institucionale, Komisioni është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Komisioni është përgjegjës para kuvendit, të cilët i zgjedhë Kryetarin dhe katër anëtarët e Komisionit. Formalisht, në masë të madhe është një organ i pavarur operativ. Komisioni mund të veprojë sipas kërkesës së



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



palës, njoftim (për shembull, për përqendrimet) ose sipas detyrës zyrtare. Komisioni gjithashtu mund të sjellë kërkesa për informacion dhe të kryejë inspektim të papritura në hapësirat e ndërmarrjeve dawn raid). Komisioni mund të shqiptojë dënime dhe të pranojë detyrime kur rregulla e konkurrencës janë shkelur.

Politikat e lehtësimit (Leniency) te vetë-paraqitësit e karteleve është vendosur, por sa më parë duhet të përdoren. Komisioni mund të miratojë përqendrimet pa ose me kusht ose të ndalojë. Komisioni gjithashtu jep mendime për projektligjet që mund të ndikojnë në konkurrencë. Vendimet e komisionit mund të paraqiten në Gjykatën Administrative.

Sa i përket **kapacitetit administrativ**, shërbimi profesional i Komisionit duket i mjaftueshëm, por niveli i tij i ekspertizës duhet të përmirësohet. Buxheti i tij ndryshon, vendoset çdo vit dhe përfshin shqetësime në lidhje me pavarësinë e tij. Sa i përket **zbatimit** aktivitetet e Komisionit janë të qëndrueshme dhe të rëndësishme në periudhën 2013-2015, me gjithsej 18 vendime të kartelit dhe keqpërdorim të pozitës dominuese me gjopa prej rreth 4.5 milion euro. Komisioni duhet të shkojë një hap më tej në aspektin e politikës së zbatimit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, në veçanti inspektimin në vend dhe programin e lehtësimit. Në vitin 2015, Komisioni dha 5 mendime mbi propozim-pjesët të legjislacionit me një ndikim në konkurrencë. Komisioni duhet të ndjekë në mënyrë aktive këto opinione në mënyrë që të respektohen. Ka shqetësime në lidhje me mungesën e pavarësisë dhe kapacitetin e gjykatave që merren me rastet antitrust.

Ndihma shtetërore

Sa i përket kornizës legjislative, LKNSH (Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore), në pjesën më të madhe është në harmonizim me nenet 107 dhe 108 të Marrëveshjes për themelimin e UE-së dhe Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim, por ende duhet të harmonizohet me *acquis* në lidhje me legjislacionin sekondar për forma të caktuara të ndihmës dhe sektorëve të veçantë. Inventari i ndihmës shtetërore ende nuk është vendosur dhe harta e ndihmës rajonale ende nuk është përgatitur.

Sa i përket **kapacitetit institucional**, Komisioni është përgjegjës për zbatimin e LKNSH-së. LKNSH parashikon që të gjitha masat e reja ose të ndryshuara të ndihmës shtetërore duhet të notifikohen në Komision për vlerësimin e pajtueshmërisë së tyre para se të miratohen. Komisioni mund të marrë një vendim negativ ose të lejojë një masë ndihme në kushte të caktuara. Nëse masa e ndihmës nuk është notifikuar në Komision, Komisioni ka fuqinë ta shqyrtojë atë më pas. Nëse Komisioni konstaton se ndihma e dhënë nuk është kompatible me LKNSH-në, mund të urdhërojë kthimin e të njëjtës.

Kapaciteti administrativ i sektorit të ndihmës shtetërore në Komision është joadekuat për shkak të mungesës së kuadrit dhe pajisjeve. Ka vetëm tre punonjës në shërbimin profesional që punojnë në rritjen e numrit të rasteve dhe pajisjeve të vjetruar.

Sa i përket **zbatimit**, Komisioni ka miratuar 25 vendime në vitin 2015. Këto vendime janë të gjitha pozitive që zakonisht lidhen me investitorët e huaj që veprojnë në zonat



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



e veçanta ekonomike dhe asnjëra prej tyre nuk është paditur. Komisioni nuk ka marrë ndonjë ankesë, që do të thotë se ka një ndërgjegjësim të ulët për rregullat e ndihmës shtetërore midis palëve të interesuara. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit lëshoi një paralajmërim për një konflikt të mundshëm interesi në lidhje me masën e ndihmës shtetërore të dhënë nga organet rajonale.

Një numër i masave të ndihmës, shumica prej tyre të miratuara në nivel qendror, janë notifikuar me vonesë dhe për këtë arsye nuk janë shqyrtuar nga Komisioni. Ndihma shtetërore vazhdon të miratohet për transportin ajror pa njoftuar Komisionin. Ndërgjegjësimi i rregullave mbi ndihmën shtetërore midis dhënësve të ndihmës duhet të rritet edhe më tej.

Liberalizimi

Rregullat anti-trust dhe rregullat për ndihmën shtetërore zbatohen për ndërmarrjet shtetërore dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç nëse zbatimi do të pengonte kryerjen e detyrave të tyre. Sidoqoftë, vendi duhet të tregojë se këto rregulla me të vërtetë zbatohen.

Nuk ka prova bindëse në lidhje me ekzistencën e monopoleve të një natyre tregtare në përputhje me nenin 37 të Marrëveshjes për themelimin e Ue-së.

8.2 Bashkëpunimi ndër-dikasterial në planin e integritimit evropian

Komisioni është bartës i Grupit të Punës NPAA 3.08 Politika e konkurrencës edhe me këtë kapacitet është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme në planin legjislativ dhe institucional për kapitullin 08 Politika e konkurrencës në drejtim të plotësimit të kushteve për anëtarësimin e RM-së në UE. Komisioni rregullisht e informonte Sekretariatit për çështje evropiane (SÇE) për progresin e arritur në planin e harmonizimit të legjislacionit nacional me asquis të UE-së dhe forcimin kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit, si dhe për shkallën e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në kapitullin 08 të Programit Nacional për miratimin e të drejtës së UE-së për 2017-2019 (NPAA 2017-2019). Si një bartës i kapitullit 8 Politika e konkurrencës, Komisioni kryesonte me takimet e rregullta mujore të grupit të punës ndër-dikasterial NPAA3.08 Politika e konkurrencës, në të cilët shikohej përparimi i arritur, aktivitetet e planifikuara dhe shkëmbeheshin informacione relevante në kapitullin me anëtarët e këtij grupi (organet shtetërore të cilët me aktivitetet e tyre kanë ndikim mbi aktivitetet ekonomike dhe shkallën e zhvillimit të konkurrencës dhe vëllimin e ndarjes së ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë). Komisioni deri te SÇE, rregullisht i dorëzonte raportet e kërkuara për përparimin e arritur në kapitullin 08 (mujore, tremujore dhe gjysmë-vjetore).

Më 3 shkurt të vitit 2016 në Shkup u mbajt takimi i 12-të i Nën-komitetit për tregun e brendshëm dhe konkurrencën ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionin Evropian. Ky nën-komitet është pjesë e strukturës, e vendosur në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësive Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare. Në takim, Komisioni e prezantoi përparimin e arritur në kapitullin 3.08 në bazë të materialit të përgatitur paraprakisht me shkrim para përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe Delegacionit të UE-së në Shkup, ku mori komente dhe sugjerime përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vend në kuptim të këtij kapitulli.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Në vitin 2016, Komisioni në mënyrë aktive mori pjesë në procesin e revizionit të NPAA, ku përgatitu kapitullin 3.08 të Programit Nacional për miratimin e të drejtës së UE-së për vitin 2017-2019.

9. Bashkëpunimi ndërkombëtar

9.1 Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral

Gjatë vitit 2016, ka vazhduar dhe është rritur bashkëpunimi me organet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës në vendet e regjionit dhe vendet anëtare të UE-së, e filluar në vitet e mëparshme, gjithashtu janë iniciuar edhe projekte të reja në kuadër të organizatave ndërkombëtare.

9.2 Bashkëpunimi bilateral

Në vitin 2016, në mënyrë intensive u realizua bashkëpunimi bilateral me organet e mbrojtjes së konkurrencës të vendeve të rajonit, ku dhe më tutje paraqet një element të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërkombëtar të Komisionit, duke u bazuar në shkëmbimin e përvojave të ndryshme në çështjet e aderimit të këtyre vendeve në Unionin Evropian, por edhe në proceset dhe përshtatjet e ekonomisë së tregut në një kuptim më të gjerë.

Më 14.04.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës së Republikës së Maqedonisë dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të Republikës së Serbisë nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së konkurrencës.

9.3 Bashkëpunimi multilateral

Në shkurt të vitit 2005, u formua OECD(Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)- Qendra Rajonale për Konkurrencë (QRK) në Budapest, Republika e Hungarisë, në kuadër të cilit organizohen seminare dhe trajnime për punonjësit e organeve kompetente të konkurrencës në vendet e Evropës Juglindore. Punonjësit e Komisionit në vitin 2016 morën pjesë në 4 seminare/punëtori të cilët u organizuan nga OECD- QRK në tema të ndryshme në fushën e mbrojtjes së konkurrencës- marrëveshjeve të kufizuara, keqpërdorimin e pozitës dominuese dhe përqendrimeve dhe në një takim vjetor të kryetarëve.

Republika e Maqedonisë është anëtare e ICN-së (Rrjeti Ndërkombëtarë për Konkurrencë) dhe në vitin 2016, Komisioni mori pjesë aktive në punën e ICN-së dhe ishte pjesëmarrëse në konferencën vjetore. ICN ndihmon në afrimin e qëndrimeve të vendeve të zhvilluara dhe vendet në zhvillim për çështjet që lidhen me rëndësinë e rregullimit efektiv të konkurrencës për zhvillimin e suksesshëm të



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



ekonomive nacionale, tërheqjen e investimeve në vendet dhe plotësimin e plotë të kërkesave të konsumatorëve, me theks të veçantë, nevojën e vazhdimit të ngritjes së kulturës konkurruese dhe të gjitha aktiviteteve që promovojnë ligjin dhe politikën e konkurrencës nëpërmjet mekanizmave jodetyruese, edukimit përkatës dhe specializimin e gjyqësorit në këtë fushë.

G. KAPACITETI ADMINISTRATIV I KOMISIONIT

Punët profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, materiale-financiare, kontabiliste, informatike dhe punët e tjera administrative-teknike, i kryen shërbimi profesional i Komisionit.

Më 31.12.2016, numri i punonjësve në Komision është 28, duke përfshirë Kryetarin dhe dy anëtarët, të cilët janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit. Të punësuarit në shërbimin profesional e kanë statusin e nëpunësve administrativ dhe personelit tekniko-ndihmës. Nga 25 të punësuar në shërbimin profesional, 19 janë me arsim të lartë, 1 me shkollim të lartë 5 janë me arsim të mesëm dhe 1 me arsim fillor.

Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, të punësuar në Komision është 12 persona, gjegjësisht 42,85%.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve që punojnë në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës është 7, të gjithë janë me arsim të lartë, ndërsa në zbatimin e Ligjit për kontrollin e Ndihmës Shtetërore punojnë 5 të punësuar, të gjithë janë me arsim të lartë.

C. KONKLUZË

Komisioni në kuadër të kompetencave të tij në vitin 2016, përveç numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në shërbimin profesional dhe mjeteve të pamjaftueshme financiare, me sukses ka përfunduar punët mbi harmonizimin dhe përshtatjen e legjislacionit në fushën e konkurrencës me të drejtën e UE-së.

Mbrojtja e konkurrencës paraqet një problematikë ligjore që vazhdimisht ndryshohet dhe plotësohet edhe në Unionin Evropian, prandaj monitorimi dhe përshtatja e legjislacionit të Maqedonisë me atë të UE-së, paraqet një proces të vazhdueshëm dhe detyrë për këtë Komision deri në arritjen e anëtarësimit në UE.

E dyta, detyrë jo më pak e rëndësishme e Komisionit, është aplikimi dhe zbatimi i rregullave të miratuara në atë mënyrë që do të mundësonte krijimin e një ekonomie të tregut, në të cilën vlejnjë rregullat e njëjta për të gjithë subjektet ekonomik në tregun e Maqedonisë, pa marrë parasysh fuqisë së tyre ekonomike.

Përgjegjësinë për zbatimin efikas të legjislacionit tashmë të harmonizuar në fushën e konkurrencës nuk e ka vetëm komisioni, por edhe Gjykata Administrative e cila vendos për ligjshmërinë e vendimeve të saj.

Komisioni duhet edhe në të ardhmen ti kryejë detyrat e caktuara që lidhen me përcaktimin e Republikës së Maqedonisë për t'u bërë anëtare e plotë e Unionit Evropian, sepse fusha e mbrojtjes së konkurrencës dhe zbatimi i kësaj dege të së drejtës në praktikë, është qëllimi kryesor i Unionit Evropian. Në lidhje me këtë, është i nevojshëm një përforsim i vazhdueshëm institucional i Komisionit, kryesisht duke rritur numrin e të punësuarve. Të gjithë të punësuarit e Komisionit duhet në



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



mënyrë të vazhdueshme të përsosën ose të fitojnë njohuri të reja, që do të jenë të gatshëm edhe sot, në procedurat konkrete të cilët i udhëheqin, ti zbatojnë standardet evropiane. Komisioni ka nevojë për një rritje të vazhdueshme të numrit të kuadrit me arsim të lartë, kryesisht në fushën e shkencave juridike dhe ekonomike, të cilët do të kenë një njohuri të mirë të ligjit dhe praktikës evropiane në fushën e konkurrencës dhe njohje të gjuhës angleze, dhe për realizimin me sukses të qëllimeve të përcaktuara dhe detyrat në një mbrojtje më efikase të konkurrencës së tregut.

Deri tani ajo që u potencua e konfirmojnë edhe mendimet e Komisionit Evropian të shprehura në raste të ndryshme me përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë, që në lidhje me çështjet në fushën e konkurrencës është bërë një progres i rëndësishëm, por kjo nuk do të thotë se edhe më tutje nuk duhet të bëjmë përpjekje më qëllim të harmonizimit të së drejtës më UE-në dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim.

Mjetet për punën e Komisionit sigurohen nga Buxheti i RM-së.

**Gj. RAPORTI FINACIAR për periudhën 01-01 deri më 31-12.2016
për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës
në llogarinë buxhetore 20056013563716**

Buxheti i Planifikuar i Komisionit për vitin 2016	19.629.000,00
1. Buxheti i miratuar sipas planit prej 01.01.2016 deri 31.12.2016	17.723.415,00
2. Shpenzimet totale prej 01.01.2016 deri 31.12.2016	17.715.596,00

Të ardhurat e realizuara sipas planeve të miratuara nga buxheti i RM-së dhe zyra e trezorit.

Sipas planit të miratuar theksojmë se të dalat janë të realizuara në bazë të nevojave, dhe sipas kontës së miratuar në bazë të planeve të Buxhetit të RM-së dhe trezorit.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë operimit të tij në vitin 2015 deri më 31.12.2016, ka bërë shpenzimet e mëposhtme, të cilët janë paguar nga mjetet në dispozicion që i kishte në llogarinë e buxhetit.

1. TË ARDHURAT NGA BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



	Të ardhurat për pagat	14.013.915,00
	Të ardhurat për udhëtime dhe mëditje	526.001,00
	Shpenzimet komunale	1.728.889,00
	Të ardhurat për materiale të ndryshme	65.299,00
	Mirëmbajtja e tanishme	59.819,00
	Shërbimet kontraktuese	697.471,00
	Reprezentacione të ndryshme	158.605,00
	Subvencionet dhe transferet	306.416,00
	Pagesa për zbatimin e dokumenteve	167.000,00
Totali	Të ardhurat për 2016	17.723.415,00

2.SHPENZIMET

401	Pagat dhe mëditjet	10.226.749,00
402	Kontributet për sigurim social	3.779.347,00
420	Udhëtimet dhe shpenzimet ditore	526.001,00
421110	Shërbime komunale të rrymës	424.056,00
421120	Shërbime komunale për furnizim me ujë	130.403,00
421130	Hedhja e mbeturinave	46.848,00
421190	Taksa tjera komunale	17.056,00
421210	Ngrohje qendrore	387.331,00
421310	Shpenzim PTT	11.918,00
421320	Telefon	326.170,00
421410	Karburante dhe vajra	71.500,00
421420	Kontrolli teknik	7.379,00
421440	Transporti i personave	306.228,00
421		1.728.889,00
423110	Material për zyra	30.160,00
423120	Mjetet për revista	16.100,00
423190	Materiale tjera administrative	450,00



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



423710	Mjetet për higjienë	13.559,00
423990	Materiale tjera	5.030,00
423		65.299,00
424110	Riparimi dhe kontrolli i Automjeteve	13.960,00
424210	Mirëmbajta aktuale e ndërtesave	5.539,00
424230	Dezinfektimi , dezinsekcion	3.000,00
424420	Riparimi dhe mirmbajta e softuerit	22.810,00
424430	Riparimi i pajisjeve	1.220,00
424440	Riparimi I mjeteve	13.290,00
424		59.819,00
425130	Marrja me qira e një lloji tjetër të hapsirës	215.250,00
425220	Provizion bankar	14.405,00
425360	Tarifa gjyqësore për peronat juridik	1.200,00
425920	Printim	2.023,00
425970	Shërbimet për konsultim	5.600,00
425990	Shërbime të tjera kontraktuese	458.993,00
425		697.471,00
426210	Reprezentacione	5.548,00
426310	Trajnime	27.184,00
426410	Shpallje në gazeta	34.616,00
426990	Shpenzime të tjera operative	90.957,00
426		158.605,00
465110	Borxhi kryesor për dokumentet ekzekutive	151.339,00
465120	Kamata (Interesi) për dokumentet ekzekutive	32.521,00
465130	Shpenzimet për dokumentet ekzekutive	122.556,00



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



465		306.416,00
480110	Blerja e pajisjeve për zyre	119.300,00
480140	Blerja e pajisjeve informatike	47.700,00
480		167.000,00
	Shpenzimet totale për vitin 2016	17.715.596,00

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar..... 19.629.000,00

Buxheti i përgjithshëm i miratuar sipas planit 17.723.415,00

Shpenzimet totale..... 17.715.596,00

Realizimi i shpenzimeve i të ardhurave sipas buxhetit të përgjithshëm të miratuar sipas planit të shprehur në përqindje është 99.96%.

VËREJTJE: Në vitin vijues 2016, Komisioni deri 31.12.2016, nuk i ka shlyer detyrimet ndaj këtyre furnizuesve me një borxh të përgjithshëm prej **359.699,00 ден.**

Emir I furnizuesit	Shuma
Mak Svis	41.305,00
Ujësjiellësi dhe kanalizimi- uji	7.924,00
Higjiena komunale- mbeturinat	3.904,00
I12 Soft	6.000,00
EVN Maqedonia – rryma	58.891,00
Telekomi I Maqedonisë	33.024,00
Posta e Maqedonisë	204,00
BEG	54.024,00
NPGazeta zyrtare	102.800,00
Ofis plus	668,00
Virtus Elias	863,00
ЈП МРТ рдт	190,00
Taksi i qytetit Sonce	24.954,00
Këshilli i furnizimeve publike	4.800,00



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Qirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Kërkesat e punëtorëve	20.148,00
Borxhi total për 2017	359.699,00